



MASH, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Agjencia Kombëtare e Provimit, Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe DAR/ZA-të.

Neni 11

Udhëzimi nr. 1, datë 5.2.2013 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM Nr. 4, datë 27.3.2013

PËR KARTËN E PAPUNËSISË

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 6 dhe 8 të vendimit nr. 70, datë 11.2.1999 të Këshillit të Ministrave “Për evidentimin e punëkërkesve të papunë”,

UDHËZOJ:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit të fillojë procedurën për nxjerrjen dhe pajisjen e punëkërkesve të papunë me kartë papunësie.
2. Procedura e nxjerrjes së kartës së papunësisë të jetë si vijon:
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në grup pune me specialistë të fushës së punësimit dhe ekspertë të fushës së prodhimit të dokumenteve të sigurtë, të përgatisë formatin e kartës së papunësisë. “Karta e papunësisë” duhet të përmbajë, përveç të dhënave për identitetin, edhe të dhëna për punësimet, kualifikimet dhe pagesat për shkak të papunësisë, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me marrëdhëniet e punësimit.
3. Pasi përgatitet “ekzemplari”, sipas përcaktimeve në pikën 2, të llogaritet kostoja e prodhimit dhe e çmimit të shitjes për çdo kartë papunësie. Ky “ekzemplar”, pasi të merret mendimi i dikastereve që shfrytëzojnë këtë dokument, t’i dërgohet për miratim ministrit.
4. Pas miratimit të ekzemplarit nga ministri, SHKP-ja fillon procedurat e prodhimit, bazuar në legjislacionin për prokurimet publike.
5. Kartat e papunësisë duhet të magazinohen në Drejtorinë e Përgjithshme të SHKP-së dhe të regjistrohen në një regjistër të veçantë, ku të shënohen edhe numrat e serive përkatëse.
Shpërndarja e tyre në zyrat e punësimit të bëhet mbi bazën e nevojave, duke shënuar në regjistër numrin e serisë për çdo zyrë punësimi.
6. Zyrat e punësimit shpërndajnë, kundrejt pagesës, kartat e papunësisë, duke shënuar për çdo person, numrin e serisë të kartës së papunësisë.
7. Shërbimi Kombëtar i Punësimit, nëpërmjet zyrave të punësimit, pajis me kartë papunësie të gjithë punëkërkesit e papunë që e kërkojnë ose pranojnë një të tillë.
7. Një punëkërkesi të papunë i jepet vetëm një kartë papunësie. Në rast të humbjes dhe dëmtimi të dokumentit, Shërbimi Kombëtar i Punësimit lëshon një “dublikatë”, e cila do të jetë e prodhuar me të njëjtat të dhëna, por me ngjyrë tjetër, dhe të ketë shënim në kopertinë “dublikatë”.

8. Shërbimi Kombëtar i Punësimit merr masa për zbatimin e këtij udhëzimi dhe informon në vazhdimësi Drejtorinë e Politikave të Punësimit në MPCSSH të për ecurinë e këtij procesi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera**

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 232, datë 11. 2.2013, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasës Brunilda Alla, e bija e Novruzit dhe e Dritës, e datëlindjes 30.4.1977, si dhe caktimin në cilësinë e kujdestarit për administrimin e pasurisë së saj, shtetasin Novruz Alla, babain e saj.